

STATUT I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR “ERMI INVEST”

Ne date 22.01.2019 ne cilesin e ortakut themelues perpilohet statuti i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar me ortak:

Roland Veseli, i biri Mehmet, lindur me 03.03.1969 ne Burrel, me adrese ndertese private 1-kateshe, fshati Hasan, Fushe Kruje, identifikuar nepermjet kartes identitetit ID numer personal G90303198V me vullnet të lire dhe të plote mbeshtetur ne Kushtetuten e Republikes se Shqiperise dhe Kodin Civil; ne ligjin nr. 9901 date 14.4.2008, “Per tregetaret dhe shoqerite tregtare”, i ndryshuar; ne ligjin “Per Qendren Kombetare te Biznesit”, ka themeluar Shoqerin me pergjegjesi te kufizuar me emertimin “**ERMI INVEST**” shpk.

KREU I

NENI 1 FORMA

Shoqeria “**ERMI INVEST**” shpk, eshte person juridik i te drejtes shqiptare, Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar (me poshte e quajtur “Shoqeria”).

NENI 2 PERSONALITETI JURIDIK

Shoqeria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në QKB, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqeria, pasi të ketë fituar personalitetin juridik, është përgjegjëse ndaj të tretëve për detyrimet dhe dëmet e shkaktuara gjatë veprimtarisë së saj.

Shoqëria “**ERMI INVEST**” shpk eshte nje e tille, kapitali i së cilës ndahet në kuota dhe që themelohet nga ortakut i vetem që përballon humbje vetëm deri në kufirin e vlerës së kontributit të tij në kapitalin themeltar.



NENI 3
SELIA E SHOQERISE

Selia qendrore e shoqerise do te jete ne fshatin Hasan, ndertese private 1-kateshe, zona kadastrale 1934, me numer pasurie 6/17, Fushe Kruje, Shqiperi.

Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijojte filiale, si brenda ashtu edhe jashte Republikes se Shqiperise, me vendim te asamblese ortakve.

NENI 4
KOHEZGJATJA

Shoqeria do te kete kohezgjatje te papercaktuar.

NENI 5
OBJEKTI VEPRIMTARISE

Objekti i veprimtarise se shoqerise do te jete: Financimin, projektimin, ndertimin, venien ne pune, administrimin, mirembajtja e hidrocentralit. Prodhimi, furnizimi, transmetimi, shperndarja, eksportimi dhe shitja e energjise elektrike. Investim ne fushen e energjise, bio gaz. Investimi, projektimi, ndertimi te paneleve diellor Eloik dhe Solar (panele diellor). Shoqeria mund te kryeje aktivitete qe nuk jane ne objektivat e saj dhe qe e favorizojne ate.

KREU II

KAPITALI

NENI 6
KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100 000 lekë dhe eshte i ndare në 1 pjesë të barabarta, vlere nominale e të cilave eshte 100 000 lekë.

Ortaku pergjigjet per humbjet e shoqerise perkundrejt te treteve deri ne vleren e kontributit te tij ne kapitalin themeltar te shoqerise;

NENI 7

ZMADHIMI DHE ZVOGELIMI I KAPITALIT THEMELTAR

Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nenshkrimeve te pjesëve te kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e nje eksperti te autorizuar per keto kontribute sipas kërkesës së administratorit.

Ne asnje rast shumica nuk mund te detyroje nje ortak per te rritur angazhimin e tij ne kapitalin themeltar te shoqerise.

Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakeve e cila merr vendim ne te njejta kushte qe kerkohen per ndryshimin e statutit.

Ne te gjitha rastet zvogelimi prek ortaket ne te njejten mase ndaj pjeseve te kapitalit qe perfaqesojne.

NENI 8

TRANSFERIMI I KAPITALIT THEMELTAR

Kuotat e kapitalit themeltar te shoqerise mund te transferohen me ane aktesh mes te gjalleve dhe me trashegimi.

Transferimi i kuotave te kapitalit te shoqerise nuk i nenshtrohet asnje lloj kufizimi, ne qoftese ndodh ne rast vdekje.

KREU III

ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

NENI 9


ORGANI VENDIMARRES

Asambleja e ortakeve (Ortaku i Vetem) eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.

Asambleja e ortakeve (Ortaku i Vetem) eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise qe miraton çdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.

Asambleja e pergjithshme e ortakeve (ortaku i vetem) eshte pergjegjese per marrjen e vendimeve per shoqerine per çeshtjet e meposhteme:

- a) percaktimin e politikave tregtare te shoqerise;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emerimin dhe shkarkimin e administratoreve;



- ç) emerimin dhe shkarkimin e likujdvesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar;
- d) percaktimin e shperblimeve per personat e permendur ne shkronjat "c" dhe "ç" te kesaj pike;
- dh) mbikqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire pregatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- e) zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit;
- f) pjestimn e kuotave dhe te anullimin e tyre;
- g) perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqerise;
- h) miratimin e rregullave proceduriale te mbledhjeve te asamblese;
- i) çeshtje te tjera te parashikuara nga ligji apo statuti;

Ortaku mund te perfaqesohet ne asamblene e pergjithshme, ne baze te nje autorizimi nga nje ortak tjetër apo nga nje person i trete.

Admnsitratori i shoqerise nuk mund te veproje si perfaqesues i ortakeve ne asamblene e pergjithshme.

Autorizimi mund te jepet vetem per nje mbledhje te asamblese se pergjithshme, e cila perfshin edhe mbledhjet vijuese me te njejtin rend dite.

NENI 10 NDRYSHIMET E STATUTIT

Çdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane Qendres Kombetare te Regjistrimit, per te pasyruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

NENI 11 ADMINISTRATORI

Administrator i shoqerise eshte **Roland Vesli**, me afat 5-vjeçar me te drejte ripërteritje. Administratori emerohet dhe shkarkohet me vendim te Asamblese ortakeve (Ortakut te Vetem) te shoqerise.

NENI 12 KOMPETENCAT E ADMINISTRATORIT

Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep



shprehimisht ortakut te shoqerise.

Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

Klauzolat e ketij statuti që kufizojnë kompetencat e administratorit, të cilat rrjedhin nga ky nen, duhet të respektohen nga të tretët.

Administratorit ose ortakut që nuk janë persona juridikë nuk u lejohe të kontraktojnë në çfarëdolloj forme qoftë, të marrin hua te shoqëria, të japin pëlqimin në emër të saj, për paradhënie si dhe të bëhen dorëzënës apo të garantojnë në emër të saj angazhimet ndaj të tretëve. Në rast të kundërt kontrata është e pavlefshme.

NENI 13

PERGJEGJESITE E ADMINISTRATORIT

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga ortaku i vetem që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale pasojat përkatëse.

Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortaku ka të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit

Ortaku ka të drejtë të ndjeke në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme.

Ortaku që nuk është administrator, ka të drejtë në çdo kohë të informohet personalisht për veprimtarinë e shoqërisë dhe të njihet me llogaritë dhe dokumentet e shoqërisë.

NENI 14

VITI FINANCIAR

Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Ortaku i Vetem brenda një afati prej gjashtë muajsh, duke filluar nga data e mbylljes së



vitit financiar, miraton raportin e administrimit, inventarin, bilancin dhe llogaritë vjetore, të hartuara nga administratorët
Ai mund të përfaqësohet edhe nga një tjetër person.

NENI 15

BILANCI I SHOQERISE DHE DIVIDENTET

Brenda 6 muajsh nga mbyllja e vitit financiar, Mbledhja e Ortakut të Vetem, miraton bilancin e paraqitur nga Administratori.

Mbledhja e Ortakut të Vetem vendos rreth shpërndarjes së dividendit, pasi të jenë zbritur humbjet e vitit të mëparshëm financiar, siç edhe parashikohet nga ligji.

NENI 16

EKSPERTET

Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabel të veprimtarisë ekonomike tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollin periodik të ushtruar prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë të ngarkuar nga ana e ortakut të vetem.

Në përfundim të kontrollit ekspertit kontabel i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për atë për kontrollin periodik të ushtruar, të cilat është i detyruar që t'ja paraqesë e dorëzojë në kohë ortakut për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.

NENI 17

Bilanci Kontabel vjetor, miratohet mbi bazën e vendimit me shkrim nga ortaku i vetem, i cili jo vetëm që dokumenton miratimin e tyre por vendos në lidhje me disponibilitetin e fondeve ligjore sipas nevojave të zhvillimit të mëtejshëm të shoqërisë dhe garantimin e veprimtarisë së rregullt të saj, duke pasur parasysh fondin e akumulimit, krijimin e fondit të vecante etj.

NENI 18

Të ardhurat neto (Dividenti) që mbeten pas vecimit të fondeve ligjore të mesipërme dhe të atyre për shlyerjen e çdo detyrimi fiskal apo likuidimin e pagesave ndaj të tjerëve, i



mbeten dhe i kalojne ne pronesi, ortakut te vetem të shoqerise.

NENI 19

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund të behet ne çdo kohe dhe per çfare do shkakut, edhe para plotesimit të afatit per të cilen eshte krijuar sic mund të jene:

Humbja e kapitalit ose pamundesia e vazhdimit të metejshem të veprimtarise se saj.

Ne nje nga menytrat e parashikuara nga ligji "Per Falimentimin e Shoqerive Tregtare".

Ne kete rast Ortaku i Vetem merr vendim me shkrim ne të cilin parashikon menyren e likuidimit të shoqerise, duke caktuar nje apo disa likuidatore dhe shenuar ne çdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtese "Shoqeri ne likuidim e siper".

NENI 20

BASHKIMI DHE NDARJA

Shoqëria, me anë të bashkimit, mund t'i kalojë trashëgiminë e saj një shoqërie ekzistuese ose një shoqërie të re që ajo themelon.

Shoqëria gjithashtu me anë të ndarjes mund t'i kalojë trashëgiminë e saj disa shoqërive të tjera ekzistuese ose disa shoqërive të reja.

Ortaku i vetem i shoqërise, që bën kalimin e trashëgimisë së saj në kuadrin e operacioneve të përmendura me lart përfiton pjesë të kapitalit themeltar nga shoqëria ose shoqëritë përfituese dhe sipas rastit një kompensim me para, vlera e të cilit nuk mund të kalojë 10 për qind të vlerës nominale të pjesëve të kapitalit themeltar.

Operacionet e përmendura me lart mund të realizohen ndërmjet shoqërive të formave të ndryshme.

Bashkimi ose ndarja sjell prishjen pa likuidim të shoqërise që zhduket, dhe kalimin e plotë të trashëgimisë së saj te shoqëritë përfituese, në gjendjen në të cilën ndodhet kjo trashëgimi në datën e realizimit përfundimtar të operacionit. Bashkimi ose ndarja sjell njëkohësisht për ortakët e shoqërive që zhduken marrjen e cilësisë së ortakëve të shoqërive përfituese sipas kushteve të përcaktuara në kontratën e bashkimit ose ndarjes.

NENI 21

Afati i emerimit të likuidatorit, publikohet sipas kushteve që parashikon ligjiperkates duke specifikuar dhe dokumentat që duhen depozituar ne Aneksin Regjistrin Tregtar.



NENI 22

Likuidatori eshte i detyruar qe te jete i vemendshem dhe korekt, si per realizimin e te drejtave per subjektet ndaj te cileve shoqeria eshte kreditore dhe per ekzekutimin e detyrimeve debive qe shoqeria ka ndaj shtetit, shtetasve te vecante apo personave fizik apo juridik vendas apo te huaj.

NENI 23

BAZA LIGJORE

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe cfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

NENI 24

MOSMARRVESHJET

Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykatat Shqiptare.

NENI 25

DISPOZITA PERFUNDIMTARE

Ky statut u redaktua ne 4 kopje me permbajtje dhe vlere te njejta juridike, dhe pasi miratohet ne parim dhe nen per nen nga Ortaku themelues i shoqerise tregtare "ERMI INVEST" shpk nenshkruset ne te gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmen orgjinale.

ORTAKU I VETEM

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

"ERMI INVEST" SHPK

Edmond Veseli
